



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.1379/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit “N.H.” BI, me seli në Ferizaj i përfaqësuar nga Daut Rudi Avokat nga Kaqaniku, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Tatimit në Pronë, me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative, jashtë seancës me datën 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Departamenti për Çështje Administrative, Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, shpallet JO KOMPETENT, për të vendosur sipas padisë të “N.H.” BI, me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Tatimit në Pronë, me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi dosja e lëndës më të gjitha shkresat e saj i dërgohet Departamentit Fiskal të Gjykatës Komerciale.

A r s y e t i m

Me datë 22.09.2022 paditësi “N.H.” BI, me seli në Ferizaj i përfaqësuar nga Daut Rudi Avokat nga Kaqaniku, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Tatimit në Pronë, me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata vlerësoj se për shqyrtim të padisë është kompetent Departamenti Fiskal i kësaj gjykate, sipas Ligjit (NR. 08/L-015) për Gjykatën Komerciale, Neni 13 ku përcaktohet kompetenca e Gjykatës Komerciale me juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe kompetenca e secilit departament

në Dhomat e Shkallës së Parë. Sipas paragrafit 4. *Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal; e që në nën-paragrafin 1.11. kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore.*

Ndërsa, në Departamentin për çështje administrative, në shkallë të parë sipas paragrafit 5, të njëjtit Nen hyjnë *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative të përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të njëjtit Nen.*

Për arsyet e cekura më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.1379/22, datë 26.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.